



KPA Nr. 002 – Aktiviteti për Bashkëpunim në Komunitet – 2021

Promovimi i llogaridhënies së qeverisjes lokale dhe krijimi i një kohezioni më të madh social në nivel komunitetesh në komunat e Kosovës

PYETJE TË SHPESHTA

1. A mund ta plotësojmë aplikacionin në ndonjë gjuhë tjetër, apo vetëm në gjuhën angleze?

Formulari i aplikacioni online, mund të plotësohet në gjuhën shqipe, serbe apo angleze. Në formularin online në anën e djathtë në fillim të faqes e zgjedhni se në cilën gjuhë dëshironi që t'i shihni pyetjet, dhe përgjigjet e juaja duhet të jenë në po atë gjuhë.

2. Cilave nga objektivat e aktivitetit për bashkëpunim në komunitet, i jepni prioritet më shumë?

Projekti juaj mund të kontribuojë në një, dy, tre apo të katër rezultatet e CCA. Në formularin e aplikimit online jeni të obliguar që të specifikoni se në cilat nga rezultat e CCA do kontribuojë projekti juaj. Pra, të dy objektivat dhe të katër rezultatet e CCA kanë prioritet të barabartë.

3. A është kanë të drejtë të aplikojnë në këtë thirrje edhe mediat, p.sh. një radio që e mbulon fushën e të drejtave të njeriut?

Po, mediat janë në listën e organizatave të pranueshme për të aplikuar në thirrjen për grante në kuadër të CCA.

4. Kur pritet të ndahen grantet për këtë rund?

Aplikantët do të njoftohen se a është përzgjedhur projekti i tyre për financim gjatë muajit prill 2021, ndërsa projektet pritet që të fillojnë implementimin nga muaji maj 2021. Kohëzgjatja e tyre nuk duhet të jetë më shumë se 8 muaj.

5. A mund të aplikoj për mbështetje për biznes familjar përmes kësaj skeme të granteve?

Grantet në kuadër të CCA nuk janë grante direkte për biznes por për mbështetje të ideve dhe aktiviteteve prej të cilave përfiton komuniteti i gjërë duke e rritur bashkëpunimin në mes të komuniteteve të etnive të ndryshme në mes vete dhe me qeverisjen e tyre lokale.

6. A duhet kostot që bëhen në kuadër të projektit të justifikohen me fatura apo vetëm të deklarohen?

Të gjitha shpenzimet e lejueshme që bëhen përgjatë implementimit të projektit duhet të justifikohen edhe me faturë.

7. Sa duhet të jetë përqindja e buxhetit për kostot administrative dhe sa për kostot e tjera?

Përqindja e buxhetit për kosto administrative (në formularin e buxhetit figuron si: Kostoja Operative) duhet të jetë nën 10% të shumës totale të buxhetit të propozuar. Poashtu, jo më shumë se 10% të buxhetit të përgjithshëm të propozuar mund të ndahet për blerjen e



USAID
NGA POPULLI AMERIKAN
OD AMERIČKOG NARODA

pajisjeve. Ndërsa për kostot tjera nuk ka restriksion sa i përket përqindjes së buxhetit, por që të gjitha kostot duhet të jenë në harmoni me aktivitetet e propozuara.

8. A pranohen kostot e kontributit pensional prej 5%?

Kontributi pensional pranohet si kosto dhe duhet të përfshihet në kategorinë e personelit.